

VENDIM
Nr.631, datë 18.9.2003

PËR RRITJEN E NIVELIT TË PAGESËS SË PAPUNËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 54 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Niveli bazë i pagesës së papunësisë të bëhet 3 960 (tre mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekë në muaj.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2003, miratuar për Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.9.2003.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano